

SYLLABUSET E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER NË ELEKTRONIKË, AUTOMATIKË DHE ROBOTIKË (2024-2027)

Viti I – Semestri I

Lënda: Qarqet dhe sinjalet në sisteme

Statusi i lëndës: Obligative (Semestri I, 7 ECTS)

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Faton Maliqi

Përmbajtja e lëndës: Karakteristikat dhe kufizimet e qarqeve lineare, karakteristikat e elementeve ideale. Sinjalet elektrike bazike, sinjalet informative, sinjalet e fuqisë. Topologjia e qarqeve elektrike, grafet. Metoda e konturave dhe nyjeve për formimin e ekuacioneve të qarkut. Ekuacionet lineare algjebrike dhe metodat për zgjidhje, matricat e rralla. Metoda e modifikuar e nyjeve, vula e elementeve. Analiza kompjuterike e qarqeve, programet e familjes SPICE dhe programi MATLAB/Simulink me veglat shtesë. Analiza e vazhduar (DC) dhe alternative (AC), sistemet e ekuacioneve diferenciale, konvolucioni, transformimi i Laplasit, funksioni transmetues, fuqia komplekse, teorema e Telegenit. Analiza në kohë dhe frekuencë me SPICE dhe MATLAB/Simulink, karakteristikat frekuencore. Qarqet me një hyrje, bartja e fuqisë maksimale, rezonanca. Rrjetat me dy hyrje. Parametrat Z, Y, S, parametrat hibrid H, Parametrat transmetues. Linjat elektrike si qarqe me parametra të shpërndarë. Përshatja e impedancave, dukuria e reflektimit në linja. Elementet jolineare, linearizimi dhe modeli shoqërues, pika e punës, analiza me sinjale të vogla, zgjidhja e sistemeve jolineare të ekuacioneve. Shndërrimet energjetike. Simulimet e qarqeve me elemente jolineare në SPICE dhe MATLAB/Simulink. Integriteti i sinjaleve, ndërlikohet, pengesat, zhurmat.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të prezantoj metodat më të avancuara të analizës së qarqeve elektrike. Njohjen me metodat kompjuterike për zgjidhjen e qarqeve elektrike lineare dhe jolineare, në domenin kohor dhe frekuencor. Përdorimi i programeve të familjes SPICE dhe e MATLAB/Simulink për analizën e qarqeve elektrike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- të njoh konceptet themelore nga teoria e grafeve, me qëllim të analizës së qarqeve me programe kompjuterike;
- të analizoj qarqet në domenin kohor dhe frekuencor;
- të njoh dhe identifikojë rrjetat me dy hyrje që gjejnë përdorim të gjërë në të gjithë lëmenjtë e elektroteknikës e posaçërisht në elektronikë, telekomunikacion, automatikë dhe energjetikë;
- të njoh karakteristikat e linjave si qarqe elektrike me parametra të shpërndarë, proceset elektromagnetike të cilat ndodhin në linja, në linjat e telefonisë, linjat për transmetime në frekuenca të larta dhe linjat energjetike;

- të përdor programet SPICE dhe MATLAB/Simulink për analizën e qarqeve elektrike;
- Të karakterizojë sistemet e ndryshme përmes s-parametrave;
- Të kuptojë konceptet e integritetit të sinjaleve;

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratë e kombinuar me simulime dhe demonstrime, diskutime, ushtrime laboratorike, projekt.

Metodat e vlerësimit: Ushtrimet laboratorike 10%, Vlerësimet intermediare 15%+15%, Projekti 30%, Provimi final 30%

Mjetet e konkretizimit/II: Kompjuter, projektor, simulator, platforma eksperimentale

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 40:60

Literatura:

1. John Semmlow, “*Circuits, signals and systems for bioengineers – A Matlab based Introduction*”, 3rd edition, Academic Press, 2018.
 2. Farid N. Najm, *Circuit Simulation*, Wiley-IEEE, 2010
 3. Alex Palamides and Anastasia Veloni, “*Signals and Systems Laboratory with MATLAB*”, CRC Press, 2011;
 4. B.P. Lathi, *Principles of Linear Systems and Signals*, Second Edition, Oxford University Press, 2009
 5. Charles K. Alexander, Matthew Sadiku, *Fundamentals of Electric Circuits*, Sixth Edition, McGraw-Hill Education, 2017
 6. Steven T. Karris, *Circuit Analysis I: with MATLAB Computing and Simulink/SimPowerSystems Modeling*, Orchard Publications, 2009
 7. Steven T. Karris, *Circuit Analysis II: with MATLAB Computing and Simulink/SimPowerSystems Modeling*, Orchard Publications, 2009
-

Lënda: **Interneti Industrial i Gjërave**
Statusi i lëndës: **Obligative (6 ECTS, 2+0+2)**
Mësimdhënësi: **Prof. Ass. Dr. Drilon Bunjaku**

Përmbajtja e lëndës: Internet of Things Industrial (IIoT) — Revolucionet e ndryshme industriale; roli i Internetit të Gjërave (IoT) dhe Internetit Industrial të Gjërave (IIoT) në industri; revolucioni i Industrisë 4.0; sistemet mbështetëse për Industrinë 4.0 dhe fabrikat e mençura (Smart Factories). Sistemet e implementimit të IIoT — Sensorë dhe aktuatorë për proceset industriale; rrjetet e sensorëve; automatizimi i proceseve dhe mbledhja e të dhënave në platformën IoT; roli i mikro-kontrolluesve dhe kompjuterëve të integruar (Embedded PC) në IIoT; nyjet pa tela të sensorëve me protokollet Bluetooth, WiFi dhe LoRa; sistemet e qendrave IoT (IoT Hub Systems). Monitorimi dhe kontrolli i të dhënave në IIoT — Portat e lidhjes IoT (IoT Gateway), sistemet Edge dhe programimi i tyre, llogaritja në re (Cloud Computing), panelet (Dashboard) në kohë reale për monitorim të të dhënave, analiza e të dhënave dhe mirëmbajtja parandaluese (Predictive Maintenance) me teknologji IIoT.

Sistemet Kibernetiko-Fizike (Cyber-Physical Systems) — Gjenerata e re e sensorëve, platformat bashkëpunuese dhe menaxhimi i ciklit jetësor të produktit (PLM), realiteti i shtuar (AR) dhe realiteti virtual (VR), inteligjenca artificiale (AI), të dhënat e mëdha (Big Data) dhe analizat e avancuara.

Aplikimet e IIoT — Sektori shëndetësor, termocentralet dhe impiantet e energjisë, menaxhimi i inventarit dhe kontrolli i cilësisë, siguria dhe mbrojtja e impianteve (përfshirë aplikimet AR dhe VR), menaxhimi i objekteve (Facility Management).

Studime raste të sistemeve IIoT — Zhvillimi i aplikimeve IIoT me përdorimin e pllakave zhvillimore me kompjuterë të integruar (Embedded PC-based development boards), zhvillimi i një mini-projekti mbi versionet e reja të sistemeve operative dhe pllakave Edge. Projekti duhet të trajtojë gjithashtu nevoja aktuale shoqërore.

Parakushtet: Njohuri themelore në automatizim, analizë të të dhënave dhe programim. Njohje paraprake e koncepteve të Internetit të Gjërave (IoT) dhe teknologjive industriale si sensorët, aktuatorët dhe rrjetet e sensorëve. Aftësi në programimin e sistemeve të integruara (Embedded Systems), mikro-kontrolluesve dhe protokolleve të komunikimit.

Qëllimet e lëndës: Të ofrojë studentëve njohuri të thelluara për projektimin e sistemeve Industrial IoT për aplikime të ndryshme industriale. Të pajisë studentët e inxhinierisë elektronike me njohuri për projektimin dhe analizën e sistemeve të Industrisë 4.0. Studentët do të mësojnë të implementojnë në mënyrë efikase sistemet IIoT, përfshirë rrjetet e sensorëve, automatizimin e proceseve, përdorimin e mikro-kontrolluesve, si dhe nyjet pa tela dhe sistemet e qendrave IoT. Po ashtu, do të zhvillojnë aftësi në monitorimin dhe kontrollin e të dhënave të IIoT, përfshirë portat IoT, programimin e sistemeve Edge, llogaritjen në re, dizajnimin e paneleve në kohë reale, analizën e të dhënave dhe teknikat e mirëmbajtjes parandaluese.

Rezultatet e pritura të të nxënit:

Në fund të kursit, studenti do të jetë në gjendje:

- Të demonstrojnë një kuptim të plotë të bazave të Internetit Industrial të Gjërave, përfshirë kontekstin historik, rolin e IoT dhe IIoT në industri dhe ndikimin e revolucioneve të Industrisë 4.0 në proceset e prodhimit.
- Të identifikojë, formulojë dhe zgjidhë probleme inxhinierike duke përdorur konceptet e Industrial IoT.
- Të implementojë zgjidhje IoT duke përdorur sensorë, aktuatorë, rrjete sensorësh, automatizim dhe mbledhje të të dhënave, për të adresuar sfida industriale reale.
- Të analizojë të dhënat e IIoT duke përdorur mjete dhe teknika të ndryshme për të mbështetur vendimmarrjen e informuar në mjedise industriale.
- Të projektojë dhe paraqesë studime rasti të IIoT që demonstrojnë kuptimin e zhvillimit të aplikacioneve dhe menaxhimit të projekteve IIoT, duke adresuar nevojat reale industriale.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata të kombinuara me simulime dhe demonstrime, diskutime, ushtrime laboratorike, dhe projekte zhvillimore.

Metodat e vlerësimit: Vlerësime ndërmjetëse: 15% + 15%, Projekti: 40%, Provimi final: 15% + 15%

Mjetet e konkretizimit / TI: Kompjuter, projektor (smart board), simulatorë, sisteme zhvillimore dhe instalime eksperimentale.

Literatura:

1. Alasdair Gilchrist, *Industry 4.0: The Industrial Internet of Things*, Publications: Apress, 2016.
 2. Bartodziej, Christoph Jan, *The Concept Industry 4.0 An Empirical Analysis of Technologies and Applications in Production Logistics*, Springer, Springer Gabler; 1st ed. 2017
 3. Raj Kamal, *Embedded System: Architecture, Programming and Design*, McGraw Hill Education, third edition, 2017
 4. Ovidiu Vermesan, Peter Friess, *Internet of Things: Converging Technologies for Smart Environments and Integrated Ecosystems*”, CRC Press, 2022
-

Lënda: **Metodologjia e hulumtimit shkencor**

Statusi i lëndës: **Obligative (Semestri I, 5 ECTS)**

Mësimdhënësi: **Prof. Dr. Milaim Zabeli**

Përmbajtja i lëndës: Kuptimi i hulumtimit shkencor dhe qëllimi. Tipet e hulumtimit shkencor. Vështrim i qasjeve metodologjike eksperimentale dhe inxhinierike për hulumtim. Metodatat/teknikat e hulumtimit shkencor. Procesi i kërkimit (formulimi i problemit të kërkimit, burimet e informacionit, formulimi i hipotezave, plani i kërkimit, mbledhja e të dhënave, realizimi i projektit, analiza e të dhënave, testimi i hipotezave, gjeneralizimi dhe interpretimi, përgatitja e raportit ose tezes). Kanale të publikimit, financimi i kërkimeve, kreativiteti dhe zbulimi intelektual. Udhëzimet dhe një kornizë për zhvillimin efikas të hulumtimit, çështjet ligjore dhe etike, mbrojtja dhe shfrytëzimi i hulumtimeve. Të drejtat e pronësisë intelektuale; Menaxhimi i projektit të kërkimit: mbikëqyrja, planifikimi dhe organizimi, problemet dhe të metat, Shkathtësitë prezantuese (me shkrim, me gojë), përdorimi i mjeteve relevante të kërkimit (teknologjia, infrastruktura eksperimentale, metodat matematikore, etj).

Qëllimet e lëndës: Qëllimi është që studentit që merret kërkime për herë të parë me disa elemente kyçe të metodologjisë së kërkimeve.

Rezultatet e pritura të nxënies: Në fund të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:

- të kuptoj disa koncepte bazike të kërkimeve dhe të metodologjive të kërkimeve;
- të identifikoj temat e përshtatshme të kërkimeve;
- të përzgjedh dhe të definoj problemin e përshtatshëm për kërkime;
- të përgatis parashtresën e projektit;
- të organizoj dhe t'i drejtoj kërkimet në mënyrë më të përshtatshme;
- të shkruaj raportin e kërkimeve dhe tezën;
- të shkruaj projekt-propozimin.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata + 1 orë ushtrime. Afërsisht 75 orë pune të pavarur.

Metodat e vlerësimit: Detyrat e shtëpisë (seminari) 30%, Vlerësimet e ndërmjetme 30%, Vijueshmëria 10 %, Provimi final 30%.

Mjetet e konkretizimit/TI: Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me videoprojektor (smart board)..

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të mësimin: 40:60

Literatura:

1. Kothari B.L., Research Methodology: Tools and Techniques, New Age International Publishers, 2013.
 2. Boot C. W., The Craft of Research, University Of Chicago Press, 2008.
-

Lënda: **Rregullimi i ngasjeve elektromotorike**

Statusi i lëndës: **Zgjedhore (Semestri I, 6 ECTS)**

Mësimdhënësi: **Prof. Dr. Qamil Kabashi**

Përmbajtja e lëndës: Hyrje. Histori e ngasjeve DC. Kontrolli elektronik. Elementet e sistemit të ngasjes elektromotorike (NEM) dhe funksioni i tyre. Dinamika e ngasjeve elektrike. Ngasjet DC. Rregullimi skalar i makinave AC. Modelimi dinamik dhe rregullimi vektorial. Rregullimi i shpejtësisë së motorëve 3fazorë më Invertorë SPWM dhe SVPWM. Rast studimor. Aplikimi i ngasjeve elektrike.

Qëllimet e lëndës: Synimi i kësaj lënde është të jap njohuri të avancuara për rregullimin e ngasjeve elektromotorike

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjëndje:

- të zgjedhë makinën për një aplikacion të veçantë bazuar në vlerësimin e fuqisë;
- të zgjedhë makinën e bazuar në karakteristikat mekanike për një aplikim të veçantë;
- të zgjedhë ngasjen me rregullim të shpejtësisë të makinave DC dhe AC;
- të njihet me rregullim skalar dhe vektorial të makinave AC.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata, 15 ushtrime laboratorike. Afërsisht 70 orë pune të pavarur përfshirë edhe projektin.

Metodat e vlerësimit: Projekti 30%, Vlerësimet intermediare 40%, Provimi final 30%.

Mjetet e konkretizimit/TI: Kompjuteri, projektori, tabela, laborator, vizita në Korporatën Elektroenergjetike të Kosovës/ Kostt/Feronikeli.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 40:60.

Literatura:

1. Bimal K. Bose, *Modern Power Electronics and AC Drives*, Pearson Education, 2002
 2. Vedam Subrahmanyam, *Electric Drives, Concept and application*, Tata McGraw Hill Education, 2nd ed. 2010.
 3. Gopal K. Dubey, *Fundamentals of Electrical Drives*, Narosa Publishing House, New Delhi, 2010.
 4. J.M.D. Murphy and F.G. Turnbull, "Power Electronics Control of AC Motors", Peragmo, 1990.
 5. **Wach Piotr**, *Dynamics and Control of Electrical Drives*, Springer, 2011.
 6. Siemens. Simovert Master Drive Vector Control, User manual (2012)
-

Lënda: **Sensorët dhe aktuatorët në robotikë**

Statusi i lëndës: **Zgjedhore (Semestri I, 6 ECTS)**

Mësimdhënësi: **Prof. Ass. Dr. Lavdim Kurtaj**

Përmbajtja e lëndës: Njohje më lëndën, struktura e robotëve në hapësirën punues. Struktura e sistemit rregullues dhe varshmëria nga llojet e sensorëve si burim i informatave. Llojet e aktuatorëve, ngasjet (motorët) elektrik, ngasjet hidraulike, ngasjet pneumatike, mekanizmat për lidhje me sistem. Modelet fizike dhe ndërlidhja me sistemin rregullues, jolinearitet dhe kufizimet. Servomekanizmat dhe sensorët për gjendjen e brendshme të robotit (proprioceptive), qarqet e shumëfishta rregulluese, sensorët e lëvizjes (pozitës, shpejtësisë), forcës dhe momentit, shtypjes, prekjës. Sensorët e orientimit (inercial), xhiroskopët, sensorët e nxitimit. Sensorët për vëzhgimin e rrethinës dhe objekteve në të, gjendja e jashtme (exteroceptive), lokalizimi (GPS, fenerët), distanca (optik, laserik, me ultrazë) dhe shpejtësia (dopler) e objekteve. Sensorët pamor, me dhe pa ngjyra (BW, RGB), pasiv dhe aktiv të thellësisë (stereo, TOF, Kinect). Përpunimi i informatave për lëvizje, orientim dhe njohje të hapësirës. Qarqet rregulluese të niveleve të larta, riveprimi pamor.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të njoftoj studentë me strukturën e robotëve në hapësirën punues. Njohja me ngasje, me aktuatorët përkatës, si dhe me sensorët për gjendjen e brendshme dhe të hapësirës që e rrethon, duke përfshirë edhe përpunimet e të dhënave që kërkohen për ti përdorë ata në qarkun rregullues.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- të njoh strukturën rregulluese të robotëve;
- të zgjedhë dhe përdorë aktuatorët adekuat për realizimin e robotëve;
- të zgjedhë dhe të përpunoj informatat e sensorëve për përcaktimin e gjendjes së brendshme të robotit dhe përdorimin e tyre në qarkun rregullues;
- të njoh, të bëjë zgjedhjen dhe ti përdorë sensorët për lëvizje dhe orientim në hapësirë;
- të përdorë sensorët pamor për nxjerrjen e informatave bazike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratë e kombinuar me simulime dhe demonstrime, diskutime, ushtrime laboratorike, projekte.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimet intermediare 15%+15%, Projekti 40%, Provimi final 15%+15%

Mjetet e konkretizimit/TI: Kompjuter, projektor, simulator, sisteme zhvillimore dhe platforma eksperimentale.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 40:60.

Literatura:

1. Peter Corke, *Robotics, Vision and Control: Fundamental Algorithms in MATLAB*, Second Edition, Springer, 2017
2. Clarence W. de Silva, *Sensors and Actuators: Engineering System Instrumentation*, Second Edition, CRC Press, 2016
3. K.S. Fu, R.C. Gonzales, C.S.G. Lee, *ROBOTICS, Control, Sensing, Vision, and Intelligence*, McGraw-Hill

4. Paul P., *Robot Manipulators Mathematics, Programming and Control*, MIT Press
 5. Bruno Siciliano, Lorenzo Sciavicco, Luigi Villani, Giuseppe Oriolo, *Robotics: Modelling, Planning and Control*, Springer, 2009
 6. Bruno Siciliano and Oussama Khatib (eds.), *Springer Handbook of Robotics*, Second Edition, Springer 2016
-

Lënda: **Sistemet Kibernetiko-Fizike**
Statusi i lëndës: **Zgjedhore (6 ECTS, 2+0+2)**
Mësimdhënësi: **Prof. Ass. Dr. Artan Mazrekaj**

Përmbajtja e lëndës: Me zhvillimin e kompjuterëve dhe zgjerimin e brezit të komunikimit, të cilët po bëhen gjithnjë e më të shpejtë dhe më të lirë, aftësitë e llogaritjes dhe komunikimit do të integrohen në çdo lloj objekti dhe strukture të mjedisit fizik. Aplikacione me ndikim të madh shoqëror dhe përfitim ekonomik do të krijohen duke shfrytëzuar këto aftësi në kohë dhe hapësirë. Sistemet që lidhin botën kibernetike të llogaritjes dhe komunikimit me botën fizike quhen “Sisteme Kibernetiko-Fizike (CPS)”. Kjo lëndë mbulon fusha të rëndësishme nga literatura kërkimore mbi CPS. Tre fusha aplikative theksohen në veçanti: pajisjet mjekësore për kujdes shëndetësor, sistemet e transportit të mençur dhe ndërtesat e mençura. Po ashtu trajtohen disa parime kyçe ndërdisiplinore, të pavarura nga fusha e aplikimit, përfshirë modelimin formal, sistemet e integruara (embedded systems), sistemet në kohë reale, kontrollin me feedback dhe rrjetet e sensorëve.

Parakushtet: Kërkohet njohuri paraprake në sistemet operative dhe në rrjetet kompjuterike.

Qëllimet e lëndës: Në përfundim të kësaj lënde, studentët do të kenë një kuptim të qartë të sistemeve kibernetiko-fizike dhe sfidave kërkimore që i shoqërojnë ato. Një nga qëllimet kryesore është që studentët të njihen me gjendjen aktuale të zhvillimit në fushën e CPS. CPS është një fushë ndërdisiplinore që kërkon parime të reja themelore. Një qëllim tjetër është njohja e detajuar me parimet e nevojshme për zhvillimin e sistemeve CPS të së ardhmes. Një objektivi shtesë është zhvillimi i aftësive në lexim kritik, prezantim dhe kërkim shkencor.

Rezultatet e pritura të të nxënimit: Në fund të kursit, studenti do të jetë në gjendje:

- Të shpjegojë rolin e Sistemeve Kibernetiko-Fizike (CPS).
- Të përshkruajë veçoritë kryesore të një Sistemi Kibernetiko-Fizik.
- Të përshkruajë aplikimet dhe sistemet CPS.
- Të aplikojë sensorët dhe aktuatorët për procese fizike. Të zbatojë modelimin e sistemit, dizajnin e bazuar në modele dhe automatat e kohës (Timed-Automata).
- Të njohë planifikimin në kohë reale për platformat me burime të kufizuara.
- Të kuptojë rolin e kontrollit me feedback në sistemet kompjuterike.
- Të njohë rolin dhe aplikimin e kompozimit të sistemeve të rrjetëzuara.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata dhe 30 ushtrime laboratorike. Rreth 80 orë studim dhe ushtrime individuale, përfshirë detyrat e shtëpisë (seminarin).

Metodat e vlerësimit: Testi 1: 20%, Testi 2: 20%, Detyrat e shtëpisë: 20%, Vijueshmëria: 10%
Provimi final: 30%.

Mjetet e konkretizimit / TI:Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me videoprojektor (smart board), ndërsa pjesa praktike do të realizohet në laborator.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike: 40 : 60

Literatura:

1. E. A. Lee and S. A. Seshia, Introduction to Embedded Systems - A Cyber-Physical Systems Approach, 2014.
 2. R. Rajkumar, D. de. Niz and M. Klein, Cyber Physical Systems, Addison-Wesely, 2017
 3. E.A.Lee and S A Shesia, Embedded system Design: A Cyber-Physical Approach, Second Edition, MIT Press, 2018.
 4. A.Platzer, (2017), Logical Foundations of Cyber Physical Systems, Springer, 2017
-

Lënda: **Teknologjia VLSI**
Statusi i lëndës: **Zgjedhore (Semestri I, 6 ECTS)**
Mësimdhënësi: **Prof. Dr. Milaim Zabeli**

Përmbajtja e lëndës: Progresi dhe zhvillimi i elektronikës dhe teknologjisë së gjysmëpërçuesve. Struktura kristallore e silicit. Teknologji planare. Parimet e procesit të integritit. Teknologjia e fabrikimit CMOS dhe rregullat e dizajnit. Metodot e dopingut në gjysmëpërçues: difuzioni dhe implantimi i joneve. Mekanizmat fizike të dopingut. Selektiviteti në teknologji gjysmëpërçuese, litografia. Parimet e izolimit dhe pasivizimi, oksidimi termal. Heqja e materialeve në teknologjinë gjysmëpërçues. Depozitimi i materialeve në teknologji gjysmëpërçues. Metodot e on-chip interkonjeksioneve të pajisjeve dhe blloqet e qarkut. Kufizimet e teknologjisë gjysmëpërçues. Materialet avancuar. Nano-teknologjia

Qëllimet e lëndës: Parimet e teknologjisë gjysmëpërçuese dhe të pajisjeve mikro dhe nano-elektronike. Teknologjia e projektimit të çipave VLSI modern.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e suksesshëm të kursit, studentët do të jenë në gjendje:

- Të përshkruajnë komponentët gjysmëpërçues elektronikë,
- Të përshkruajnë strukturën kristallore të silicit.
- Të shpjegojnë ecurinë e procesit të fabrikimit – hapat kryesorë (teknologjia e fabrikimit CMOS) dhe rregullat e dizajnit.
- Të kuptojë proceset e oksidimit, difuzionit, litografisë, implantimit, metalizimit,
- Të analizojë prerjet tërthore të strukturave të tranzistorit; Identifikoj parimet bazë të hapave të fabrikimit në teknologjinë gjysmëpërçuese.
- Të dijë kufizimet e teknologjisë moderne gjysmëpërçuese.
- Integroj hapat e procesit për prodhimin të MOS -ve dhe tranzistorëve bipolar.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, Ushtrime numerike (simulative), Konsultime, Seminare.

Metodat e vlerësimit: Testi 1: 25%, Testi 2: 25%, Detyrat e shtëpisë (seminari): 20%, Provimi final: 30%

Mjetet e konkretizimit/TI: Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me videoprojektor (smart board), kurse pjesa praktike do të realizohet në sallat e ushtrimeve numerike (laboratorike).

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të mësimin: 40:60

Literatura:

- James D. Plummer, Michael Deal, Peter B. Griffin, Silicon VLSI Technology: Fundamentals, Practice, and Modeling, Prentice Hall, 2009.
 - Stanley Wolf, Richard N. Tauber, Silicon Processing for the VLSI Era, Vol. 4: Process Technology, Lattice Press, 2002
 - P. Biljanović, Mikroelektronika Integrirani elektronički sklopovi, Školska knjiga, 2001
-

Lënda: Matjet dhe sensorët në biomedicinë

Statusi i lëndës: Zgjedhore (Semestri I, 6 ECTS)

Mësimdhënësi: Prof. Dr. Sabrije Osmanaj

Përmbajtja e lëndës: Koncepte themelore: burimet e sinjaleve biomedicionale, llojet e sinjaleve, karakteristikat e zhurmës së sistemit matës. Madhësitë fizike dhe fiziologjike që maten në biomedicinë dhe në njësitë përkatëse. Mënyrat e marrjes së sinjaleve në natyrë. Parimet themelore fizike të sensorëve: resistivë, induktivë, kapacitivë, piezoelektrik, kimikë, optikë. Matja e shtypjes (matjet direkte dhe indirekte). Matja e rrjedhës së gjakut dhe e frymëmarrjes. Matja e lëvizjes, shpejtësia, nxitimi, forca dhe momenti. Matja e temperaturës, lagështisë dhe nxehtësisë. Matja e potencialeve bioelektrike (elektrokardiografi, elektroencefalografi, elektromiografi), impedanca bio, bioelektrodat. Metoda matëse laboratorike, biosensorët. Sensorët e dritës, sensorët e bazuar në fibra optike, metoda optike matëse.

Qëllimet e lëndës: Përmbledhje e variablave fizikë dhe fiziologjikë që maten më së shpeshti në një mjedis mjekësor, me fokus në qëllimet specifike të matjes së tyre. Kuptimi i parimeve fizike, metodave të matjes si dhe sensorët për matjen e këtyre madhësive në diagnostikën mjekësore. Fitimi i njohurive dhe përvojës praktike për përfitimin e sinjaleve më të zakonshme bioelektrike në sipërfaqen e trupit (EKG, EMG dhe EEG) dhe lloje të ndryshme të sinjaleve biologjike joelektrike (p.sh. metodat e matjes optike). Njohja bazë e koncepteve për matjen e parametrave kimikë dhe biosensorëve. Përvoja praktike me metodat matëse në laborator. Njohja e avantazheve dhe kufizimeve të metodave matëse ekzistuese me qëllim të zgjedhjes së metodës më të përshtatshme për një përdorim specifik.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, studentët duhet të jenë në gjendje të: përshkruajnë metoda të ndryshme të matjes dhe sensorët në medicinë dhe bioteknologji; përshkruajnë disa nga metodat dhe procedurat më të rëndësishme të matjes dhe të shpjegojnë përparësitë dhe kufizimet e tyre; të shpjegojë mjedisin fizik të metodave të matjes; planifikoj dhe bëjë matje biomedicionale në zona të tjera; të interpretojë rezultatet e marra gjatë matjes.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe teren, konsultime, seminare, detyra shtëpie, vlerësime, provime.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimi në klasë 20%; Projekti 30%; Vlerësimi përfundimtar 50%.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 40:60

Literatura:

1. Wang P, Liu Q. Biomedical Sensors and measurement. Zhejiang University Press, Springer, 2011.
2. Tatsuo Tagawa, Toshiyo Tamura, P. Ake Oberg; Biomedical Sensors and Instruments, Second Edition; CRC Press, 2011
3. Khandpur RS. Biomedical Instrumentation: Technology and Applications. McGraw-Hill, 2004.

4. Bronzino JD (editor). The Biomedical Engineering Handbook (3rd edition). CRC Press, 2006.
 5. Olfa Kanoun, Nabil Derbel, [Advanced Sensors for Biomedical Applications](#), Springer, 2021
 6. Tatsuo Tagawa, Toshiyo Tamura, P. Ake Oberg, Biomedical Sensors and Instruments 2nd Edition, CRC Press; 2 edition (March 22, 2011)
 7. John G. Webster Halit Eren , Measurement, Instrumentation, and Sensors Handbook Electromagnetic, Optical, Radiation, Chemical, and Biomedical Measurement, SECOND EDITION, CRC Press, 2014.
-

Lënda: Elektronika energjetike e avancuar

Statusi i lëndës: Zgjedhore (Semestri I, 6 ECTS)

Mësimdhënësi: Prof. Dr. Qamil Kabashi

Përmbajtja e lëndës: Pajisjet e avancuara gjysmëpërçuese të fuqisë: MOSFET-ët , IGBT,GTO, IGCT etj, modulet inteligjente të fuqisë, dizajnimin termik, mbrojtjen, qarqeve ngasëse të gejtave, përdorimi i DSP-së në kontrollin e tyre. Konvertorët DC-DC me dhe pa izolim siç janë: Buck, bust, flyback, forward, Cuk, SEPIC, gjysmë urë, push-pull dhe urë në DCM dhe CCM, korrigjimi i faktorit të fuqisë në furnizim AC të këtyre konvertorëve, zbatimi i tyre në SMPS, UPS, saldim dhe sistemet e ndriçimit. Përmirësimi i kualitetit të fuqisë të konvertorëve AC-DC. HVDC (High Voltage Direct current) konvencional, VSC bazuar sistemet fleksibile HVDC. Ky modul bazohet në ngasje gjysmëpërçuese të motorëve induktiv duke përfshirë këtu kontrollin vektorial (SPVM), motorët sinkron, me magnet të përhershëm me brusha DC (PMLDC), LCI (Load Comutaded Inverter), ngasjet motorike sinkrone me “raport ushqimi të lartë”, konservimi i energjisë dhe përmirësimi i kualitetit të fuqisë në këto këto ngasje.

Qëllimet e lëndës: Në këtë kurs studentët do të njihen me pajisjet më të fundit të elektronikës energjetike dhe aplikime të tyre në sistemet e konvertimit të energjisë.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimi të suksesshëmtë kësaj lënde studentët do të kuptojnë:

- pajisjet gjysmëpërçuese dhe aplikimi në sistemet elektronike të fuqisë;
- operimin e qarqeve konvertuese të fuqisë,
- aplikimin dhe çështjen e implementimit të sistemeve të Elektronikës Energjetike.
- teknikat moderne për ngasje të motorëve me shpejtësi të ndryshueshme duke përfshirë këtu metodën aktuale me vektorë hapësinorë.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe teren, konsultime, seminare, detyra shtëpie, vlerësime, provime.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimi në klasë 20%; Projekti 30%; Vlerësimi përfundimtar 50%.

Mjetet e konkretizimit/TI: Kompjuteri, projektori, tabela, laborator, vizita në mjedisë të ndryshme energjetike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 40:60

Literatura:

1. Daniel W. Hart, Power Electronics, McGraw-Hill Education; 1st. Ed. 2010.
 2. N. Mohan, T. M. Undeland and W. P. Robbins, Power Electronics, Converter, Application and Design, 3rd ed, John Willey & Sons, 2007.
 3. Frede Blaabjerg, Control of Power Electronic Converters and Systems, Volume 1, Academic Press; 1st ed. 2018
 4. Bin Wo, *High Power Convertes and AC drives*, IEEE press, 2006
 5. B. K. Bose, *Power Electronics and Variable Frequency Drive*, Standard Publishers Distributors, 2000.
-

Lënda: **Siguria Kibernetike**
Statusi i lëndës: **Zgjedhore (Semestri I, 6 ECTS)**
Mësimdhënësi: **Prof. Dr. Blerim Rexha**

Përmbajtja e lëndës: Hyrje në Sigurinë Kibernetike dhe sfidat e ndryshme që e karakterizojnë atë. Dobësitë dhe sulmet në sigurinë kibernetike. Kontrolli i qasjes dhe politikat e sigurisë. Sigurimi i aplikacioneve, shërbimeve dhe serverëve në ueb. Siguria në Internetin e Gjërave (IoT Security). Zbulimi dhe parandalimi i ndërhyrjeve (Intrusion Detection and Prevention). Enkriptimi dhe kriptografia. Menaxhimi i rrezikut dhe planifikimi emergjent. Hapësira kibernetike dhe legjislacioni. Forenzika kibernetike dhe menaxhimi i incidenteve.

Parakushtet: Njohuri themelore mbi rrjetet kompjuterike, sistemet operative dhe protokollet e internetit. Kuptim i parimeve të kriptografisë dhe masave të sigurisë si enkriptimi dhe kontrolli i qasjes. Njohuri për menaxhimin e rrezikut dhe aspektet ligjore të sigurisë kibernetike.

Qëllimet e lëndës:

- Të kuptohet baza e sigurisë kibernetike dhe sfidat e saj, përfshirë kërcënimet, sulmet dhe dobësitë në botën digjitale.
- Të identifikohen metodat e kontrollit të qasjes, politikat e sigurisë dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e rrjeteve, sistemeve dhe të dhënave nga qasja e paautorizuar dhe cenimet e sigurisë.
- Të zhvillohen aftësi për zbulimin, parandalimin dhe trajtimin e kërcënimeve kibernetike, përfshirë qasjen e paautorizuar, ndërhyrjet e hakerëve dhe shkeljet e sigurisë.
- Të aplikohen teknikat e enkriptimit dhe kriptografisë për sigurimin e të dhënave dhe komunikimeve digjitale, duke përdorur algoritme sigurie dhe certifikata digjitale.
- Të zhvillohen aftësi në menaxhimin e rrezikut dhe planifikimin emergjent për t'iu përgjigjur shkeljeve të sigurisë kibernetike, përfshirë identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve, si dhe përgatitjen për emergjenca dhe rikuperimin nga dëmet.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Në përfundim të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të:

1. Vlerësojë konceptet, teoritë dhe strategjitë themelore të sigurisë kibernetike që aplikohen në studime konkrete të rasteve reale.
2. Identifikojë, zbatojë dhe përshkruajë teknika efektive të kontrollit të qasjes, politika sigurie dhe praktika të mira për mbrojtjen e rrjeteve, sistemeve dhe të dhënave nga qasja e paautorizuar dhe cenimet e sigurisë.
3. Shpjegojë zgjidhje teknike dhe jo-teknike të sigurisë në lloje të ndryshme të sistemeve kibernetike.
4. Vlerësojë rreziqet, dobësitë dhe kërcënimet në sisteme të ndryshme kibernetike.
5. Identifikojë cilësitë dhe kompetencat që lidhen me profesionistët e sigurisë kibernetike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata dhe diskutime në klasë (30 orë) dhe 30 orë ushtrime laboratorike. Studime rastesh dhe projekte praktike, lexime dhe analiza e materialeve të shkruara, si dhe demonstrime praktike të mjeteve të sigurisë kibernetike.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimi në klasë: 10%, Projekti: 40%, Vlerësimi final: 50%.

Mjetet e konkretizimit / TI: Gjatë ligjëratave do të përdoren kompjuterët, projektorët dhe tabelat interaktive, ndërsa pjesa praktike do të realizohet në laborator.

Literatura:

1. Charles J. Brooks, Christopher Grow, Philip A. Craig Jr., Donald Short. Cybersecurity Essentials, Sybex, 1st Edition, 2018.
 2. Robin Sharp. Introduction to Cybersecurity: A Multidisciplinary Challenge. 1st Edition Springer, 2024.
 3. [Yuri Diogenes](#), Erdal Ozkaya. Cybersecurity. Attack and Defense Strategies, 3rd Edition, Packt Publishing, 2022.
-

Semestri II

Lënda: **Projektimi digjital**
Statusi i lëndës: **Obligative (Semestri II, 6 ECTS)**
Mësimdhënësi: **Prof. Dr. Milaim Zabeli**

Përmbajtja e lëndës: Elementet e qarqeve logjike, projektimi i qarqeve logjike sinkrone dhe asinkrone. Implementimi i qarqeve digjitale (numëruesve, regjistrave) me module të larta duke shfrytëzuar qarqe të integruara me funksione fikse sinkrone dhe asinkrone. Projektimi VHDL, kodet për funksionet e portave logjike të thjeshta. Projektimi (dizajnimi) i qarqeve logjike kombinuese me VHDL. Dizajnimi i qarqeve bistabile memoruese me VHDL. Dizajnimi i makinave të gjendjeve të thjeshta me VHDL. Dizajnimi i qarqeve digjitale në nivel algoritmik dhe RTL. Qarqet PLD të programueshëme. Bazat e qarqeve të programueshëme FPGA. Dizajnimi i makinave komplekse të gjendjeve me VHDL.

Qëllimet e lëndës: Dizajnimi i qarqeve dixhitale komplekse duke përdorur qarqe të integruara me funksione fikse dhe mjete të avancuara të projektimit; përshkrimi i sistemit RTL dhe dizajni i sistemit dixhital duke përdorur qasjen HDL.

Rezultatet e pritura të nxënies: Të dijë dhe kuptoj:

- dizajnimin (projektimin) e qarqeve dixhitale bazike,
- implementimi (projektimin) e qarqeve dixhitale komplekse duke përdorur IC me funksione fikse dhe vegla të avancuara të projektimit në një nivel më të avancuar,
- përdorimin e VHDL,
- procedurat dhe metodat (stilet) e dizajnit të qarqeve digjitale;
- dizajnimin (projektimin) e makinave të gjendjeve për raste specifike.
- dizajnimin e qarqeve konvencionale dhe jokonvencionale sekuenciale
- Të dizajnoj qarqe PLD.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata, 30 orë ushtrime laboratorike. Afërsisht 80 orë pune të pavarur përfshirë detyrat e shtëpisë (ose punimin seminarik).

Metodat e vlerësimit: Detyrat individuale të kryera në klasë 30%; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 30%; Vijushmëria 10 %, Provimi final 30%.

Mjetet e konkretizimit: Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me videoprojektor (smart board), kurse pjesa praktike do të realizohet në laborator.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të mësimin: 40:60

Literatura:

1. Richard S. Sandige, Michael L. Sandige, Fundamentals of Digital and Computer Design with VHDL, McGraw-Hill, New York, NY 10020, 2013,
 2. Thomas Floyd, Digital Fundamentals, eleventh edition, Pearson Education Limited, 2015.
 4. Mano, M. Morris, Kime, Charles R. Logic and computer design fundamentals, 2008 Upper Saddle River : Pearson Prentice Hall.
-

Lënda: **Sistemet e dedikuara**
Statusi i lëndës: **Obligative (Semstri II, 6 ECTS)**
Mësimdhënësi: **Prof. Ass. Dr. Faton Maliqi**

Përmbajtja e lëndës: Ligjërata hyrëse mbi mundësitë që ofrojnë kompjuterët me një kapsulë (single capsule computers) dhe sistemet e dedikuara (embedded systems). Studenti përcakton një fushë të veçantë brenda sistemeve të dedikuara në konsultim me mësimdhënësin përgjegjës të lëndës dhe mbikëqyrësin e caktuar. Studenti gjithashtu ka mundësinë të zgjedhë një fushë të veçantë brenda sistemeve të dedikuara në bashkëpunim me kompani industriale apo kërkimore.

Parakushtet: Bazat e sistemeve mikrokontrolluese. Aftësi në programim (p.sh. C/C++, Python). Elektronika digjitale dhe njohuri mbi mikro-kontrollues (Arduino, Raspberry Pi, etj.). Mjete të simulimit dhe implementimit (p.sh. Keil, Proteus, MPLAB, Simulink).

Qëllimet e lëndës:

Të zhvillohen zgjidhje të përshtatshme për aplikime specifike bazuar në specififikimet e dhëna. Kërkim i pavarur: Mbledhja dhe paraqitja e njohurive të fituara në mënyrë të pavarur në një fushë të zgjedhur brenda sistemeve të dedikuara.

Vlerësim kritik: Diskutim dhe vlerësim i tezave kryesore nga libra ose raporte kërkimore në fushën e zgjedhur.

Zbatim praktik: Aplikimi ose simulimi i njohurive të fituara përmes shembujve konkretë, aty ku është e mundur.

Rezultatet e pritura të të nxënit: Qëllimi i kësaj lënde është të ofrojë mundësinë e fitimit të njohurive të avancuara në fushën e sistemeve të dedikuara, të cilat nuk mbulohen nga kurset standarde.

Në përfundim të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

- propozojë zgjidhje të përshtatshme për aplikime të caktuara bazuar në specififikimet;
- përmbledhë dhe paraqesë njohuritë e fituara në mënyrë të pavarur në një fushë të zgjedhur të sistemeve të dedikuara;
- diskutojë dhe vlerësojë tezave qendrore, për shembull, në libra ose raporte kërkimore në fushën e zgjedhur;
- aplikojë njohuritë e fituara përmes implementimeve ose simulimeve të shembujve konkretë.

Metodologjia e mësimdhënies: 30 orë ligjërata (përfshirë zgjidhjen e problemeve praktike) dhe 30 orë ushtrime laboratorike. Rreth 80 orë studim dhe ushtrime individuale, përfshirë detyrat e shtëpisë.

Metodat e vlerësimit: Detyrat individuale në klasë: 30%, Detyrat individuale në shtëpi: 30%, vijueshmëria: 10%, Provimi final: 30%.

Mjetet e konkretizimit / TI: Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me videoprojektor (smart board), ndërsa pjesa praktike do të realizohet në laborator.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike: 40 : 60

Literatura:

1. Peter Marwedel, Embedded System Design: Embedded Systems, Foundations of Cyber-Physical Systems, and the Internet of Things, Springer, 2018.
 2. Tianhong Pan, Yi Zhu, Designing Embedded Systems with Arduino - A Fundamental Technology for Makers, Springer, 2018.
 3. Alexander Barkalov, Larysa Titarenko, Małgorzata Mazurkiewicz, Foundations of Embedded Systems, Springer, 2019.
 4. James K. Peckol, Embedded Systems: A Contemporary Design Tool, Wiley, 2019.
 5. Alan Holt, Chi-Yu Huang, Embedded Operating Systems: A Practical Approach, Springer, 2018.
-

Lënda: **Robotika dhe automatizimi**

Statusi i lëndës: **Obligative (Semestri II, 6 ECTS)**

Mësimdhënësi: **Prof. Ass. Dr. Lavdim Kurtaj**

Përmbajtja e shkurtër: Njohje me lëndën dhe llojet e automatizimit: i fiksuar, i ndryshueshëm, i programueshëm. Robotët: industrial (manipulatorët), mobil, modular, bashkëpunues. Përdorimi i robotëve dhe hapësirat e veprimit. Automatizimi në industri dhe përpunim, NC, CNC, robotët. Celula punuese me robot. Robotët në detyrat ndihmëse dhe shërbyese. Veprimi në hapësira të rrezikshme. Robotët në edukim dhe argëtim. Specifikimet për robot. Robotët industrial dhe ndërtimi, struktura, kinematika, dinamika, rregullimi, dora dhe kapëset. Lëvizja dhe detyra punuese, planifikimi i trajektorës, prej-pike-në-pikë, rruga e vazhduar, me kontakt dhe ushtrim të forcës në mjedis. Programimi i robotëve, on-line, off-line, paneli për komandim dhe mësuarje. Robotët në industri dhe ndërlidhja me sistemin për automatizim, PLC-të, nivelet e ndërlidhjes (sinjale dhe ndërfaqe komunikuese). Mënyra e udhëheqjes (me dhe pa sensor të rrethinës) dhe koordinimi me pajisjet tjera (transportuese, makineritë, bashkëvepruesit). Hapësira e strukturuar dhe e pastrukturuar. Përshtatja në ndryshime, sensorët dhe sistemi pamor. Riveprimi pamor. Planifikimi i veprimeve dhe përdorimi i inteligjencës artificiale. Robotët edukativ dhe lojërät (Lego NXT, FIRA). Simulatorët, grafika dhe lojërät kompjuterike.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të njoftoj studentët me përdorimin e robotëve në detyra të ndryshme të automatizimit industrial, përpunuese dhe shërbyese. Theksi do të jetë në hartimin e sistemit, realizimin me PLC ose me kompjuter të dedikuar, dhe programimin për kryerjen e veprimeve të kërkuara.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- të njoh strukturën e sistemeve automatike dhe vendin e robotëve në to;
- të njoh mundësitë e përdorimit të robotëve në punë të ndryshme dhe specifikimet përkatëse;
- të integroj robotët me sisteme automatizimit (PLC-të) me sinjale apo me ndërfaqe komunikuese;
- të programoj detyra të ndryshme punuese në sistemet e integruara;
- të kuptojë dhe të përdorë në rregullime me riveprim informatat nga sensorët e rrethinës (pranisë, distancës, prekjes, pamor).

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërätë e kombinuar me simulime dhe demonstrime, diskutime, ushtrime laboratorike, projekte/

Metodat e vlerësimit: Vlerësimet intermediare 15%+15%, Projekti 40%, Provimi final 15%+15%.

Mjetet e konkretizimit/TI: Kompjuter, projektor, simulator, sisteme zhvillimore dhe platforma eksperimentale

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 40:60.

Literatura:

1. Thomas R. Kurfess, *Robotics and Automation Handbook*, CRC Press, 2005

2. A.K. Gupta, S.K. Arora, Jean Riescher Westcott, *Industrial Automation and Robotics: An Introduction*, Mercury Learning & Information, 2016
 3. Zongwei Luo and Zongwei Luo, *Robotics, Automation, and Control in Industrial and Service Settings*, IGI Global, 2015
 4. Bruno Siciliano, Lorenzo Sciavicco, Luigi Villani, Giuseppe Oriolo, *Robotics: Modelling, Planning and Control*, Springer, 2009
 5. K.S. Fu, R.C. Gonzales, C.S.G. Lee, *ROBOTICS: Control, Sensing, Vision, and Intelligence*, McGraw-Hill
 6. Peter Corke, *Robotics, Vision and Control: Fundamental Algorithms in MATLAB*, Second Edition, Springer, 2017
 7. Bijoy K. Ghosh, Ning Xi, T.J. Tarn, (Eds.), *Control in Robotics and Automation: Sensor-Based Integration*, Academic Press, 1999
 8. Bruno Siciliano and Oussama Khatib (eds.), *Springer Handbook of Robotics*, Second Edition, Springer 2016
 9. Frank D. Petruzella, *Programmable Logic Controllers*, Fifth Edition, McGraw-Hill, 2017
-

Lënda: **Identifikimi i sistemeve**
Statusi i lëndës: **Zgjedhore (Semestri II, 6 ECTS)**
Mësimdhënësi: **Prof. Ass. Dr. Faton Maliqi**

Përmbajtja e lëndës: Qasjet e ndërtimit të modelit, modelet matematikore. Paraqitja përmes modelit “Kutia e zezë”. Identifikimi jo-parametrik: identifikimi më domen kohor përmes analizës së korrelacionit, analiza përmes përgjigjes frekuencore, analiza e përgjigjes frekuencore përmes metodës së korrelacionit. Analiza Furie, vazhdimësia e ngacimit. Identifikimi parametrik: metodat e gabimit të parashikimit, modelet e parashikimit, analiza e vlerësimit LS, konvergjenca dhe konsekuenca. Zgjidhja e strukturës së modelit. Miratimi i modelit.

Qëllimet e lëndës: Lënda merret me teknikat e identifikimit me theks në familjen e modeleve të gabimit të ekuacionit që përdoren për parashikim dhe rregullim. Në fund të kursit studenti duhet të fitoj aftësi për të përdorë veglat identifikuese në modelimin e proceseve reale dhe vlerësimin e kualitetit të modeleve.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e kursit studenti duhet të jetë i aftë:

- të njoftoj studentin me bazat e modelimit të sistemeve të vazhduara dhe diskrete dhe me procedurat themelore të identifikimit;
- të kuptoj veglat për simulim dhe identifikim të sistemeve në domenin kohor, frekuencor dhe kompleks;
- të pajisë studentin me aftësi për të përdorë kompjuterin për simulim, modelim dhe identifikim të sistemeve;
- Të propozojë dhe zbatojë zgjidhje për probleme të thjeshta identifikimi;
- Të validojë një model të sistemit që është identifikuar dhe krahasoni modele të ndryshme të thjeshta;
- Të dizajnojë një eksperiment për të identifikuar një sistem të thjeshtë;
- Të zhvillojë një kuptim më të thellë të identifikimit të sistemit nga vetë ai/ajo nëse është e nevojshme për të zgjidhur probleme më komplekse

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata të kombinuara me simulime dhe demonstrime, diskutime, ushtrime laboratorike, projekte.

Metodat e vlerësimit: Detyrat e laboratorit 10%, Vlerësimet e ndërmjetme 30%, Projekti 30%, Provimi final 30%.

Mjetet e konkretizimit: Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me video-projektor, kurse pjesa praktike do të realizohet në laborator përmes modelimit dhe identifikimit të modeleve laboratorike të sistemeve dhe verifikimin e metodave të identifikimit në kompjuter.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të mësimit: 40:60

Literatura:

1. R. Isermann, “*Identification of Dynamic Systems: An Introduction with Applications*”, Springer, 2005.
 2. L. Ljung, “*System Identification: Theory for the User*”, Prentice Hall, 1999.
 3. T. Soderstrom and P. Stoica, “*System Identification*”, Prentice Hall, 1989.
-

Lënda: Rregullimi i proceseve me kompjuter

Statusi i lëndës: Zgjedhore (Semestri II, 6 ECTS)

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Drilon Bunjaku

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të njoftoj studentët me përdorimin kompjuterëve për rregullimin e proceseve, duke përdorur format e ndryshme të rregullatorëve PID dhe atyre digjital. Do të mbulohet procesi nga hartimi deri te realizimi përfundimtar, me kompjuter të dedikuar ose si prototip i shpejtë.

Përmbajtja e lëndës: Njohje me lëndë. Struktura e sistemit për rregullim të proceseve e bazuar në kompjuter, elementet e sistemit, lloji i procesit (grupor ose vargor, i vazhduar, i kombinuar ose hibrid), lloji i sistemit kompjuterik (mbikëqyrës, për rregullim digjital të drejtpërdrejtë), arkitektura e sistemit kompjuterik (e centralizuar, e shpërndarë, hierarkike), ndërfaqja njeri-makinë (panelet monitoruese dhe kontrolluese). Struktura konstruktive dhe programore e kompjuterit për rregullimin e proceseve, grumbullimi i të dhënave, përpunimi, veprimi, komunikimi dhe lidhjet në rrjetë, programi për punë në kohë reale, programet ndihmëse. Specifikimet e sistemit rregullues, hartimi i rregullatorit, akordimi. Rregullatori PID digjital, ngopja e integritit, variantet, mënyrat e akordimit. Modelimi dhe identifikimi, modelet parametrike, proceset testuese. Metoda e riveprimit rele, vetë-akordimi i PID-it. Rregullatorët digjital, me vonesë minimale, pa oscilime, pa oscilime i rendit të rritur. Rregullatorët e gjendjes. Rregullatorët për procese me kohë-të-vdekur (me vonesa-të-pastër-kohore). Sjellja ndaj pengesave, PID me dy shkallë të lirisë. Sistemet rregulluese të ndërlidhura dhe shumë variabile, rregullatorët PID dhe digjital. Realizimi digjital i rregullatorëve, kuantizimi, filtrimi. Kombinimi i algoritmit rregullues dhe aktuatorit. Krijimi i shpejtë i prototipit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

- të njoh strukturën e sistemit kompjuterik që përdoret për rregullimin e proceseve;
- të modeloj proceset dhe ti rregulloj ata me rregullator PID;
- të realizoj pjesën elektronike dhe atë programore të rregullatorit PID me vetë akordim me metodën e riveprimit rele;
- të hartoj rregullator digjital dhe të gjendjes për proceset që kërkohen;
- të hartoj rregullator PID me dy shkallë të lirisë për rregullim dhe shuarje të pengesave;
- të kuptojë dhe të analizojë sistemet e ndërlidhura dhe shumë variabile;
- të implementoj projekt praktik i cili ndërlidh dizajnimin, implementimin dhe analizimin e rregullimit të procesit me kompjuter.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratë e kombinuar me simulime, diskutime, ushtrime laboratorike dhe projekte.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimet intermediare 10%+10%, Ushtrimet laboratorike 20%, Projekti 30%, Provimi final 30%

Mjetet e konkretizimit/TI: Gjatë ligjëratave do të përdoret kompjuteri me videoprojektor, kurse pjesa praktike do të realizohet në sallat e ushtrimeve numerike (laboratorike).

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të mësimit: 40:60

Literatura:

1. S. K. Singh, *Computer-Aided Process Control*, Prentice-Hall, 2005
 2. Rolf Isermann, *Digital Control Systems*, Springer-Verlag, 1981
 3. Karl J. Åström, Tore Hägglund, *Advanced PID Control*, ISA, 2006
 4. Su Whan Sung, Jietae Lee, In-Beum Lee, *Process identification and PID control*, IEEE Press, 2009
 5. Cheng-Ching Yu, *Autotuning of PID Controllers: A Relay Feedback Approach*, Springer, 2006
 6. Qing-Guo Wang, Zhen Ye, Wen-Jian Cai, Chang-Chieh Hang, *PID Control for Multivariable Processes*, Springer, 2008
-

Lënda: Sistemet operative në kohë reale

Statusi i lëndës: Zgjedhore (Semestri II, 6 ECTS)

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Lavdim Kurtaj

Përmbajtja e lëndës: Njohje me lëndën, sistemet operative, historiaati, hardueri i kompjuterit, sistemet operative në kohë reale ndaj atyre jo në kohë reale, pronsia, të lira dhe me kod burimor të hapur. Konceptet basike, proceset vargore, bashkëpunimi mes proceseve, komunikimi mes proceseve, semaforët, zonat kritike të kushtëzuara, rradhët e ngjarjeve, bllokimet, administrimi i procesorit, algoritmet e planifikimit, modeli rreshtor i sistemit, admisnistrimi i ruajtjes në memorie, programimi i hyrje/daljeve dhe struktura e ndërprerjeve, adminstrimi i pajisjeve, administrimi i informatave, siguria. Analiza e kërkesave të sistemeve reale në kohë, dekompozimi i funksioneve, ujditë ndërmjet harduerit dhe softuerit, konceptet e sistemeve të ndërpërfshira. Konceptet e sistemeve operative të shpërndara, sistemet e dosjeve, mënyra e llogaritjes, balancimi i ngarkesës, renditja e ngjarjeve, sinkronizimi, përjashtimi reciprok i shpërndarë, problemi i filozofëve që pijnë, bllokimet në sistemet e shpërndara.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të njoftoj studentët me përdorimin, hartimin dhe realizimin e sistemeve operative në kohë reale, posaçërisht zbatimin e tyre në sistemet e ndërpërfshira, si dhe shqyrtimin e harduerit të përshtatshëm. Gjatë kohëzgjatjes së kursit studentët do të ndërtojnë një sistem operativ në kohë reale të thjeshtë por mjaft komplet.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- të shpalosë karakteristika e sistemit operative në kohë reale (RTOS) dhe të krahasojë sistemet me kërkesa të forta dhe të buta për punë në kohë reale;
- të ndërtoj sisteme të ndërpërfshira me ndonjë RTOS të gatshëm;
- të shkruaj aplikacione që krijojnë dhe fshijnë detyrat, që kontrollojnë planifikuesin e detyrave dhe që marrin informata për detyra;
- të hartoj dhe të programoj RTOS të thjeshtë për sisteme kompjuterik specifik;
- të testoj dhe të verifikoj rendimentin e RTOS;
- të kuptojë dhe të përdorë sistemet operative të shpërndara.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratë e kombinuar me simulime dhe demonstrime, diskutime, ushtrime laboratorike, projekte.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimet intermediare 15%+15%, Projekti 40%, Provimi final 15%+15%

